TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

SPECIAL ANTI-MOLD

BOJË PLASTIKE ANTI MYK
E CILËSISË SUPERIORE

PËRSHKRIMI TEKNIK

SPECIAL ANTI-MOLD është një bojë me bazë uji e cilësisë superiore të një teknologjie të re, e cila bazohet në rezina të akrelikut kopolimer. Boja karakterizohet nga një mikrosferë e veçantë termo-izoluese dhe ruan në mënyrë konstante një performancë të lartë.
Është produkt i një formule të veçantë dhe për këtë arsye e ruan temperaturën e brendshme të pandryshueshme duke mos lejuar krijimin e mikro-organizmave dhe mykut mbi sipërfaqet e lyera.
Për të njëjtën arsye lufton mykun dhe mikro-organizmat e krijuara tek sipërfaqja që lyhet. Nuk përbën rrezik për përdoruesin apo mjedisin. Nuk ka përmbatje metali. Është e disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe në një shumëllojshmëri ngjyrash të prodhuara përmes sistemit të ngjyrave **ZEUS-AL**.
Është e përshtatshme për përdorim të brendshëm.

CILËSITË

Rezistencë e lartë ndaj mykut, rrezeve ultra-violet dhe kushteve atmosferike. Karakterizohet nga nje mbulueshmëri shumë e mirë, dhe është resistente ndaj pastrimit. Mund të lahet lehtë me ujë duke qenë se nuk dëmtohet nga detergjentët. Aplikohet lehtë, nuk mban erë dhe është rezistente ndaj zverdhjes. Ka bardhësi perfekte. Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për mbrojtje të lartë ndaj mykut dhe mikro-organizmave të krijuara gjatë aplikimit të dekorimeve mbi sipërfaqet e brendshme, të cilat janë me suva, allçi, stuko, beton, dru, etj.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/a (Bojra për mure të brendshme dhe tavane) : 75g /l (2007) dhe 30g /l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 12 g/l VOC.(Bazat 25g/l VOC)

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

SPECIAL ANTI-MOLD

BOJË PLASTIKE ANTI MYK
E CILËSISË SUPERIORE

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër, e thatë, pa praninë e shtresave të mëparshme të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, etj.
Sipërfaqet e dëmtuara duhet të stukohen më parë me SPECIAL STUCCO të **ZEUS-AL**.
Sipërfaqet e reja ose sipërfaqet poroze të lyera me parë me gëlqere ose me bojë me cilësi të dobët, duhet të trajtohen me parë me një dorë astar LATEX të **ZEUS–AL** të holluar deri në masën 300% - 400% me ujë dhe pas tharjes të aplikohen dy duar me **SPECIAL ANTI-MOLD**.
Për një rifreskim të sipërfaqeve të lyera me përpara me bojë aplikoni direkt dy duar me **SPECIAL ANTI-MOLD** .
Nëse duam te rrisim efikasitetin në lyerje të sipërfaqeve të cilat kanë qënë me parë të lyera, aplikojmë më parë një dorë me astar FIXDUR të holluar deri në masën 100% me BRUSH SOLVENT No100 t ë **ZEUS-AL**.

Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me ujë sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-10% me ujë sipas peshës.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 shtresa mbi sipërfaqen e pastruar dhe të përgatitur mirë.
Temperatura e aplikimit: 5 deri në 35 ° C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë dhe me ngjyrë
Rezina: Kopolimer akrelik
Densiteti (e bardhë): 1.45±0.05 gr/ml (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti i produktit në prodhim: 100±5 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Viskoziteti i produktit në magazinim: 110±10 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Substanca të ngurta sipas peshës (e bardhë): 62±1% (EN ISO 3251-03)
Substanca të ngurta sipas vëllimit (e bardhë): 62±1% (ISO 3233-98)
pH: 8.5-9.0 (ISO 976-96)
Temperatura minimale e formimit të filmit : 0 ºC (ASTM D 2354)
Qëndrueshmëria në paketim: 10/10 (1 muaj, 50°C) (ASTM D 1849-03)
Shkëlqimi, në 85°: 6±2 (ELOT EN ISO 2813-99)
Koha e tharjes në 25° C:
- Tharja në sipërfaqe: 25-40 min
- Tharja në brëndësi: 45-60 orë
- Rilyerja: pas 1-2 orë

Pika e ndezjes: n.a. (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në çimento(ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Mbulimi: 12-13 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura mirë.

Shënim:
- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të lahen 20-30 ditë pas aplikimit të bojës, në rast se është e nevojshme.
- Mbi sipërfaqe me suvatim të freskët, rekomandohet që produkti të aplikohet të pakën 30-40 ditë më pas.
- Rekomandohet shmangia e aplikimit të produktit në temperatura nën 0°C ose pak para shiut.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com